Kronikë

VIDEO/ Shkodër, 48 vjeçari hedh pistoletën në lulishte e tenton t'i ikë policisë

Helidon Marku është arrestuar nga policia në Shkodër, pasi është kapur me armë pa leje. 48-vjeçari sapo ka parë policinë, ka zbritur nga makina dhe është përpjekur që të largohet, ndërsa ka tentuar që të fshehë armën e zjarrit që mbante me vete

HOROSKOPI

Redaksia
15 Shkurt, 13:47 | **Përditesimi: 15 Shkurt, 14:05**

Share

Helidon Marku është arrestuar nga policia në Shkodër, pasi është kapur me armë pa leje.

48-vjeçari sapo ka parë policinë, ka zbritur nga makina dhe është përpjekur që të largohet, ndërsa ka tentuar që të fshehë armën e zjarrit që mbante me vete.

Por është kapur nga forcat e policisë dhe është arrestuar në flagrancë. Arma e zjarrit pistoletë me municion luftarak dhe automjeti tip "BMË" që drejtonte ky shtetas, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Shkodra i bashkohet festimeve të karnavaleve në Tuz të Malit të Zi, banda frymore e 'djepit të kulturës' dhuroi spektakël për banorët

'Si rezultat i administrimit të menjëhershëm të inteligjencës policore, se një shtetas mbante armë zjarri, pa leje, shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër kanë organizuar punën në kuadër të operacionit "Sundimi i ligjit" dhe kanë ndërhyrë menjëherë për arrestimin e këtij shtetasi.

Në bulevardin "Skënderbeu" është lokalizuar automjeti me drejtues shtetasin H. M., i cili sapo ka parë shërbimet e Policisë, ka dalë nga automjeti dhe është larguar afër një lulishteje ku ka tentuar të fshehë armën e zjarrit që mbante me vete. Si rezultat i veprimeve të shpejta policore është kapur shtetasi H. M., 48 vjeç, banues në lagjen "Ndoc Mazi", i cili në përfundim të veprimeve procedurale u arrestua në flagrancë. Arma e zjarrit pistoletë me municion luftarak dhe automjeti tip "BMW" që drejtonte ky shtetas, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.'- njofton policia.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: helidon marku | Shkoder

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Duhet të rihetohet Berisha për kryengritjen e armatosur të 14 shtatorit '98?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

VIDEO/'Përjetësisht e jemja', Bashkia Shkodër surprizon për ditën e Dashurisë
14 Shkurt, 11:48

Bardhi njeh Berishën si kryetar: Do respektoj vullnetin e shumicës! Grupi Basha? Në rrugë të gabuar, i ftoj të na bashkohen
14 Shkurt, 11:16

Hodhi në lum foshnjën e saj 6 ditëshe dhe u rrëfye te murgeshat, dënohet me 22 vite burg 32 vjeçarja në Shkodër! Kërkoi mëshirë para gjykatës
Ergys Kavaja
13 Shkurt, 15:56

Shkodër/ 54 vjeçari dëmtohet aksidentalisht duke pastruar armën e gjahut
12 Shkurt, 17:10

Atentati ndaj Selami Brahimit, motivi dyshohet konflikti familjar! Autori i dyshuar, xhaxhai i gruas së 60-vjeçarit
Ergys Kavaja
12 Shkurt, 10:30

Reshje të dendura dëbore në aksin Bogë-Theth, 2 borë pastruese punojnë për të mbajtur hapur rrugën
12 Shkurt, 09:44

Shkodër/ Ishte shpallur në kërkim për vjedhje nga policia e Tiranës, 27-vjeçari arrestohet në pikën kufitare të Muriqanit
11 Shkurt, 10:17

Tentoi të vriste Selami Brahimin, zbardhet atentati në Shkodër! Autori ishte arratisur në Gjermani, u kap në Berlin (EMRI)
10 Shkurt, 16:30

Malësi e Madhe/ Vodhën një furgon dhe e fshehën në pyll, arrestohet 19-vjeçari, në hetim 2 të mitur
10 Shkurt, 13:03

VIDEO/ Mbrëmje në Shkodër, xhiro me dron në 'djepin e kulturës'
9 Shkurt, 20:32

Guroret ndotin ujin, banorët e Postribës në protestë: Të ndërhyjë shteti, ose e zgjidhim me kanun! Takojnë kryebashkiakun, Beci: Do kërkoj verifikimin e lejeve
Ergys Kavaja
9 Shkurt, 19:49

Oreksi vjen duke ngrënë, Qatip Osmani: Vllaznia kërkon 6 pikë kundër Teutës dhe Egnatias
9 Shkurt, 17:57

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje